

## **Hapet thirrja për aplikime për bursa në Universitetin Çukurova në Turqi, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA 107.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për mësimdhënie në Universitetin Çukurova në Turqi, për stafin akademik të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + KA107 për vitin akademik 2018 - 2019.

### **Llojet e mobilitetit:**

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

### **Fushat e shkëmbimit:**

- Kimi
- Matematikë dhe Statistikë;
- Shkencat e Natyrës;
- Bioteknologji;

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

Për më shumë informacion mbi Universitetin e Cukurovës ju lutemi referohuni linkut:

<https://www.cu.edu.tr/>

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin për stafin (140 EUR në ditë për stafin);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV (në gjuhën angleze) + Lista e publikimeve;
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze niveli B2);
- Vetëdeklarim nëse ka kryer më parë mobilitet Erasmus+;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

[https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus/files/files/resources/mobility-agreement-teaching\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/sites/erasmusplus/files/files/resources/mobility-agreement-teaching_en.pdf)

\*Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

**Afati për aplikim:** 31 tetor 2018

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara të dërgohen në adresën [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Sektorin për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al)

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!